



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENË DANA: 14.05.2026			
SHËNJA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOB
01-052/01-21949			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	14.05.2026
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi – Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkryetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik nga Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton raport nga procesi i konsultimit publik të Planit Komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme në Komunën e Lipjanit (2026-2028). Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e **Draft Planit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030** së bashku me zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i platformes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43016>

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/1-Vendim-per-konsultimit-e-publikut-Plani-i-Transportit-pdf.pdf>

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Statutit në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike kanë publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 23.03.2026 për mbajtjen e konsultimit-debatit për *Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030*

në linkun:

<https://lipjan.rks-gov.net/news/mbahet-debat-publik-per-draft-planin-e-transportit-rrugor-te-udhetareve-me-autobus-ne-territorin-e-komunes-se-lipjanit-2026-2030/>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 28.04.2026 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora ora 10:00

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

Linku: <https://lipjan.rks-gov.net/news/mbahet-debat-publik-per-draft-planin-e-transportit-rrugor-te-udhetareve-me-autobus-ne-territorin-e-komunes-se-lipjanit-2026-2030/>

Drejtori i Shërbimeve Publike, Sead Aliu, para të pranishmëve prezantoi Draft-Planin e transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit për periudhën 2026–2030, duke u fokusuar edhe në rregullativën ligjore përkatëse.

Sead Aliu sqaroi para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë Draft Plan i cili pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth këtij drafti plani.



Sead Aliu sqaroi para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë Draft Plan i cili pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth këtij drafti plani.

Gjatë këtij takimi është kërkuar nga të gjithë të jenë sa më aktivë gjatë fazës së konsultimit publik dhe të kontribuojnë me ide dhe rekomandime që kanë për synim avancimin e mëtejshëm të dokumentit.

Po ashtu u dhanë propozime konkrete nga pjesëmarrësit lidhur me këtë dokument.

Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, duke përfshirë: fushëveprimin e këtij plani analizën e gjendjes ekzistuese, objektivat, transportin publik, planin e veprimit dhe oraret e udhëtimit sipas linjave.

Tutje në vazhdim të këtij takimi Sead Aliu, Drejtor i Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim të Komunës së Lipjanit diskutoj për fushëveprimin e këtij plani me fokus të veçantë objektivat dhe gjendjen e transportit në komunën e Lipjanit, si dhe i spjegoj të gjitha nenet radhazi të këtij plani. Krejt në fund i paraqiti edhe oraret dhe rendet e udhëtimeve sipas linjave.



Takimi përfundoi në ora 10:40.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	15 ditë pranohen	15
2. Publikimi në ueb faqe	15 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 15 pjesëmarrës, prej tyre 10 femra dhe 5 meshkuj.

Po ashtu kemi pranuar edhe disa komente të cilat do i listojmë më poshtë.

Temat e konsultimit	komentet	Kush ka komentuar	Pergjegja ne pyetje komente	Komenbtet (ppranimi i pjeseshem dhe mos pranimi)
Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030	Ka ngritur shqetësimin e tij si operator lidhur me operimin në teren të operatorëve auto taksi të cilët theksoi se paraqesin shqetësim për kompanitë e autobusëve lidhur me marrjen e udhëtarëve.	Shaqir Fazliu – nga kompania e transportit të udhëtarëve me autobus “Erona”	Komisioni sqaruar se kjo çështje është kompetencë e inspektoriatit komunal i cili mbikqyr operatorët autotaxi në terren me rregullativ ligjore të veçantë.	Komenti nuk pranua që të përfshihet në këtë plan
Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030	Ka parashtruar pyetjen se a është i përfshirë në këtë plan relacioni Kojstk-Lipjan.	Rinor Murati – anëtar i kuvendit komunal të komunës së Lipjanit	Komisioni ka pranuar ka pranuar komentin lidhur me paragrafin edhe ka inkorporuar në këtë plan.	Komenti u pranua plotësisht

Gjatë fazës së diskutimit publik lidhur **Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030**, Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranuar nga palët e interesuara

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin dhe zbatimin e konsultimeve publike



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

LISTA E PJESMARRSVE NË DEBATIN PUBLIK PËR PLANIN E TRANSPORTIT, I
MBAJTUR MË 28.04.2026

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1.	Dinor Murati	
2.	VLORA KRAJMIQI	
3.	Sazana Demiri - Rexhepi	
4.	Rakete Jekocai	
5.	Valdete Thipi	
6.	Emine Mustafa Deliu	
7.	SHADIR FAZLILU	
8.	MERITA MAGASHI	
9.	Shetko-kë Dedushë - Gashi	
10.	MELTOR FAZLILU	
11.	Fatbardha Shumhigi	
12.	shelinde Sopa	
13.	Linda Shaluni	
14.	Scop Thipi	
15.	shelil Alehati	
16.		
17.		
18.		
19.		
20.		
21.		
22.		
23.		
24.		
25.		
26.		
27.		
28.		